



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:042889

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01182135

P. nr. 531/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit F B , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.257/17 të dt.05.5.20207, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit F B dhe të prokurorit të shtetit Arlinda Nallbani –Gacaferi me dt.132.10.2020 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri F B i lindur me dt.... në Pejë rruga ... pa nr , ku edhe tani jeton , i biri i H dhe nënës SH e gjinisë O , i njohur me dokument identifikues numër ..., ka të kryer shkollën e mesme i pa punë , i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar më parë nga gjykata, Rom , shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me datë 31.1.2017 , rreth orës 103:00 në Pejë rruga ... , pikërisht në shtëpinë e tij , me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtarit - vëllait të tij SH B , në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari ndodhej në shtëpi së bashku me nënën e tij , i pandehuri kërkon ushqim për të ngrënë , e pasi nuk i pëlqen ushqimi të cilin e ofron nëna e tij , fillon fillimisht të fjalohet me të dëmtuarin , e më pas fillojnë të përleshet , ku gjatë përleshjes i pandehuri e godet të dëmtuarin me kokë , në vetullën e majtë , e si pasojë e goditjes sipas akt ekspertizës mjeko –ligjore , të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore.

-me çka ka kryer veprë penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së I SHQIPTON

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurit i behët me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë veprë penale për të cilën nëse ai sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë dhe të shpenzimeve të procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.05.5.2017 kundër të pandehurit F B ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.257/17, për vepër penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë - e ka pranuar

Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , e që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , , gjendjen e varfër ekonomike por edhe faktin se i dëmtuarit e që [është vëllai i të pandehurit , me dt. 23.5.2018 në këtë gjykatë sipas shënimit zyrtar ka deklaruar se : kundër të pandehuri nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtrij kërkesë për kompensimin e dëmit , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.12.10.2020.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .